



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQËRIA RAJONALE E UJËSJELLËS – KANALIZIME FIER SH.A**

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Fier, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**  
*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Studim Projektim: “Rikonstruksion i Ujesjellesit per fshatin Mbrostar Ura NJA Mbrostar, Bashkia Fier”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Studime Inxhinierike 71335000-5**

**VLERA E FONDIT LIMIT : 2.471.020 (dy milion e katerqind e shtatedhete e nje mije e njezete) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Sh.a.Ujesjelles-Kanalizime” Fier, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Perllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike eshte kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës(a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM”

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Fier ShA, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

- Sipas Shtojcës Nr. 9

2.1.1. Te jete i specifikuar në QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

- **Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.9 për ato pika të cilat mund të plotësohen me anë të Vetëdeklarimit sipas Ligjit.**
- **Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 30% vlerës së përlllogaritur e kontratës që prokurohet.**

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të një pasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. *Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.*

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për vitin **2025** (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

***Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar sipas vlerës së fondit limit të kësaj procedure, sipas nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, si dhe neneve 43 dhe 47, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim që autoriteti kontraktor të kuptojë nëse operatorët ekonomikë ofertues kanë apo zotërojnë mundësitë e nevojshme financiare për të përmbyllur punët publike me sukses. Xhirot e tre viteve të fundit janë 2023, 2024, 2025, që rezulton të jenë përmbyllur edhe sipas legjislacionit tatimor. Përqindja e kërkuar mbi xhiron vjetore është një përqindje minimale sipas RRPP-ve dhe xhiro e tre vjetëve e kërkuar, jo vetëm që përputhet me praktikën administrative të prokurimeve publike të ndjekur deri më tani, por është e rëndësishme për të vlerësuar kapacitetin ekonomik të ofertuesit dhe kuptuar nëse është i aftë financiarisht për të përmbyllur punët publike pranë autoritetit kontraktor. Po kështu, që nga operatorët ekonomikë të vërtetohet kapaciteti ekonomik, ata mund të paraqesin kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2023, 2024, 2025, si mbas xhirove vjetore, të depozituar pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar. Paraqitja e bilanceve është një mundësi, në rast se operatori ekonomik ofertues paraqet xhirot e kërkuara. Këto kërkesa të vendosura në DST (për mundësinë e paraqitjes së bilanceve dhe detyrimin e paraqitjes së dokumenteve për xhiron vjetore) përputhen edhe me nenin 9 të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, sipas të cilëve periudha e raportimit financiar është 12 muaj dhe periudha e depozitimit të pasqyrave financiare është nga 12-15 muaj.*

Gjithashtu, për të vërtetuar kapacitetin ekonomik, operatori ekonomik ofertues duhet të depozitojë vërtetim që konfirmon shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti lokal për tre vitet e fundit, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku ai ushtron aktivitetin sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së/QKB-së. Kjo kërkesë buron nga neni 76 i LPP-së, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, sipas të cilëve subjektet tregtare kanë detyrimin që të paguajnë taksat vendore, me qëllim që të ushtrorjnë aktivitetin. Vitet përkojnë me 2023, 2024, 2025. Të gjitha kërkesat lidhur me kapacitetin ekonomik janë të bazuara në legjislacionin e përmendur më sipër dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse ofertuesit kanë kapacitete për të nisur dhe përfunduar punët publike që prokurohen. Po kështu, duke qenë se mund të marrin pjesë si ofertues edhe bashkime operatorësh ekonomikë, atëherë secili prej operatorëve ekonomikë të bashkuar, duhet të depozitojë dokumentacionin si më lart. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”; si dhe shkronjës c, të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ku parashikohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”. Po kështu, kjo kërkesë bazohet edhe në udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë **jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur** të objektit që prokurohet.
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.
  - Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose në vlerën limit të kontratës për punët totale të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Këto vlera janë vlerat minimale të kërkuara sipas RRPP-ve. a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; Situacion Përfundimtar dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor. b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme pranë subjekteve private, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor. Dokumentet e mësipërme janë të mbështetura edhe në legjislacionin në fuqi të zbatueshëm për ndërtimet. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE. Kjo kërkesë bazohet në nenet 88 e në vijim të LPP.

- 2.3.2** Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

**Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:**

**1.PROJEKTIM URBANIST**

c - Plane të detajuara vendore.

**2.PROJEKTUES ARKITEKT**

d-Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

**3.PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

a- Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

b-1 Objekte civile - industriale - turistike mbi 5 kate.

#### **4.PROJEKTUES INSTALATOR**

a- Projektim te instalimeve hidro -termosanitare

c- Projektim te linjave te rrjeteve elektrike m per objekte civile industrial.

#### **5.PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE**

b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.

c- Proejktim ujesjelles kanalizime urbane -rurale

#### **6.PROJEKTUES RRUGE-HEKURUDHE**

a- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore

#### **7.PROJEKTUES VEPRA ARTI**

a-Projektim ura dhe vepra arti te vogla deri 10m

#### **8.PROJEKTUES GJEODET**

a-Rilevime inxhinierike.

c-Sisteme GIS.

#### **9.STUDIM GJEOLOGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK**

a-Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate.

#### **10.PROJEKTUES TE SINJALIZIMIT RRUGOR**

a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” - lidhja 4 “kushte dhe kritere specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

<b>KATEGORIA E KËRKUAR</b>	<b>PIKAT E KATEGORISE</b>	<b>PERSHKRIMI PER KATEGORITE</b>
<b>Kat.1.PROJEKTIM URBANIST</b>	c- Plane të detajuara vendore.	Bazuar ne termat e references projektuesi urbanist do te jete i domosdoshem per konceptimin e sistemimit te zonave ku do te ndertohen objekte dhe hartimin e PDV.
<b>Kat.2.PROJEKTUES ARKITEKT</b>	a- Projektim arkitekturor për objekte banimi – objekte industriale - objekte turistike. d-Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe. b-Objekte sportive te mbuluara ose pjeserisht	Bazuar ne termat e references projektuesi arkitekt eshte kerkuar ne funksion te shërbimeve të lidhura kryesisht me projektimin e objekteve te sherbimit te ujesjellesave , depove dhe pikqve te manovrimit.
<b>Kat.3.PROJEKTUES KONSTRUKTOR</b>	a- Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate. b-1 Objekte civile – industriale - turistike mbi 5 kate	Bazuar ne termat e references projektuesi konstruktor do te jete i domosdoshem për projektimin e veprave inxhinierike, ndërtimit dhe operimit e Impianteve te Trajtimit te Ujerave te Ndotura, për projektimin e ujesjellesave ,depove ,stacione te pompimit dhe infrastruktures ndertimore .
<b>Kat.4.PROJEKTUES INSTALATOR</b>	a- Projektim te instalimeve hidro termosanitare c- Projektim te linjave te rrjeteve elektrike m per objekte civile industrial.	Bazuar ne termat e references projektuesi instalator do te jete i domosdoshem për projektimin e sistemeve të klorit , pajisjeve te monitoriit te alarmit, sistemeve te automatizuara , ndricimit rrugor etj.
<b>Kat.5.PROJEKTUES VEPPRA HIDRAULIKE</b>	b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi. c- Proejktim ujesjelles kanalizime urbane rurale	Bazuar ne termat e references projektuesi vepra hidraulike do te jete i domosdoshem për projektimin e sistemeve të ujesjellës-kanalizimeve
<b>Kat.6.PROJEKTUES RRUGE HEKURUDHA</b>	a-Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.	Bazuar ne termat e references projektuesi rruge hekurudha do te jete i domosdoshem për projektimin e rrugeve dhe

		infrastruktura e aksesit , siguron standartet teknike te rugeve , koordinon realizimin e puneve te ndertimit me kerkesat ligjore.
<b>Kat.7.PROJEKTUES VEPRA ARTI</b>	a-Projektim ura dhe vepra arti te vogla deri 10m	Bazuar ne termat e references projektuesi ruge hekurudha do te jete i domosdoshem per projektimin e rugeve dhe infrastrukturen e aksesit per transportin e mbetjeve , siguron standartet teknike te rugeve , koordinon realizimin e puneve te ndertimit me kerkesat ligjore.
<b>Kat.8.PROJEKTUES GJEODET</b>	a- Rilevime inxhinierike. c-Sisteme GIS.	Bazuar ne termat e references projektuesi gjeodet do te jete i domosdoshem per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me rilevimin e kuotave gjeodezike, kordinative te rruges dhe te gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i furnizimit me ujë, pusetave te kontrollit , pusetave te ajrimit, pusetave te shkarkimit , depove rregulluese, të jepet plani i piketimit dhe verifikimi paraprak në terren për saktësinë e të dhënave përpara fillimit të projektit të zbatimit. Bazamente gjeodezike , rilevime ne te gjitha shkallet , projektim fotogrametrik ,hartografike topografike etj .
<b>Kat.9.STUDIM GJEOLOGO- INXHINIERIK HIDROGJEOLOGJIK</b>	a-Studim/vlerësim gjeologo- inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate	Bazuar ne termat e references projektuesi gjeolog do te jete i domosdoshem për shërbime të kërkuara të lidhura kryesisht me studimet gjeologjike, hartimin e relacionit gjeologjik, hartimin preventivit dhe analizat e çmimeve për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik përpara fillimit te projektit te zbatimit ,te shërbimeve të lidhura kryesisht me projektimin e strukturave mbrojtese si membrana izoluese, vleresim te struktures gjeologjike , stabilitet te terrenit , perdorimin e metodave gjeofizike per vleresimin e nentokes etj
<b>Kat.11.PROJEKTUES TE SINJALIZIMIT RRUGOR</b>	a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.	Bazuar ne termat e references projektuesi do te jete i domosdoshem për projektimin e rrugëveve e brendshme teknike ne stacione, përfshirë hyrjen dhe rrugët e lidhjes me rrjetin rrugor ekzistues.

**2.3.3** Një punësim mesatar i të paktën **14 (katermbedhjetë)** personave të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Përcaktimi i fuqisë punëtore minimale të kërkuar është bazuar në shpërbimet e kërkuara sipas Detyres së Projektimit objekt prokurimi. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Gjithashtu duke ju referuar intensitetit të shërbimeve nevojitet operator ekonomik me staff të organizuar dhe të qëndrueshem për të garantuar shërbimet.

**2.3.3** Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV ku të kenë të paktën 10 vite eksperiencë, diplomë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi Struktura/Civile Industriale
- 1 (një) Inxhinier Profili Infrastruktura/Rruge Ura
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

Drejtimesit teknik si më sipër duhet të jenë të punësuar prane shoqërisë dhe të përmbushin kriteret sipas parashikimeve të vendimit nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

**2.3.5** Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë staf inxhinierik për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV , diplomë konkretisht:

- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Stafi i mesiperm, do të realizojë projektet sipas kompetences dhe licences bazuar në VKM nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

**2.3.6** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë staf mbështetës për realizimin e këtij shërbimi punonjësit e mëposhtëm të cilet duhet të jenë të deklaruar në listepagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (nje) Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin nëpërputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate.

- 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10237 datë 18/02/2010 "Përsigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Përsigurinë në kantier", shoqëruar me kontratën individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikate.
- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate "Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë.
- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate Ekspert VNM "Hartimin e Raporteve per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" e cila të jetë e lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit ndihmës i eshte referuar Termave References .

### **2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:**

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI/ISO 9001-2015 e perditesuar (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI/ISO 14001- 2015 e perditesuar (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI/ISO 45001:2018 e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001 – 2023) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Shënim:** Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.6 gërma "a"- "c" janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i

akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve që do shërbejnë për ofrimin e shërbimit të projektimit, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- 1 (nje) pajisje GPS
- 1 (nje) total station
- 1 (nje) Dron Fotogrametrik
- 1 Automjet 4x4 ,

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë: dokumentacion për pajisjen në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit si pas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertues i kualifikuar i pari, për para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pajisje, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me realizimin e shërbimit.

- 1 pajisje GPS janë pajisje të domosdoshme për matjet topografike, kërkohen 2 pasi zona që do mbulohet është në gjithë territorin e bashkisë
- 1 pajisje Total janë pajisje të domosdoshme për matjet topografike, kërkohen 2 pasi zona që do mbulohet është në gjithë territorin e bashkisë
- 1 pajisje Dron i pajisur me LIDAR, është pajisje që shërben për matje topografike e domosdoshme për zona të paaksesueshme dhe të mbuluara me bimësi
- 1 Automjet 4x4, mjet i domosdoshëm pasi terrenet kanë një vështirësi aksesimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” dhe nenit 78 pika 2 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

### ***NJËSIA E PROKURIMIT***

1. \_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_ 3. \_\_\_\_\_